

**Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 1701/2003, datë 24 shtator 2003, në përputhje me nenin 6 të Rregullores (KE) nr. 1592/2002 të Parlamentit European dhe të Këshillit, për rregullat e përgjithshme në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit European.**

*Gazeta Zyrtare L 243, 27.9.2003, fq. 0005 - 0005*

Rregullorja e Komisionit (KE) nr.1701/2003 datë 24 shtator 2003 në përputhje me nenin 6 të Rregullores (KE) nr. 1592/2002 të Parlamentit European dhe të Këshillit,për rregullat e përgjithshme në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit European (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në).

## KOMISIONI I KOMUNITETEVE EUROPIANE

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European,

Duke pasur parasysh Rregulloren (KE) nr. 1592/2002 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 15 korrik 2002, për rregullat e përgjithshme në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit European [(1) dhe në veçanti nenin 6 pika 2 të saj,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Neni 6 pika 1 i Rregullores (KE) nr.1592/2002 kërkon produkte, pjesë dhe pajisje që të përputhen me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit të Shtojcës 16 të Konventës për aviacionin civil ndërkombëtar (këtu e më poshtë referuar si Konventa e Çikagos) lëshuar në nëntor 1999, përveç shtesave të saj.
- (2) Konventa e Çikagos dhe shtojcat e saj janë ndryshuar që me miratimin e Rregullores (KE) nr. 1592/2002, që kërkonte përshtatjen e nenit 6 pika 1 në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 54 pika 3 të së njëjtës rregullore.
- (3) Masat e parashikuara në këtë rregullore janë në përputhje me mendimin e Komitetit të Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit European, të përcaktuar nga neni 54 i Rregullores (KE) nr.1592/2002.

### KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

#### Neni 1

Në nenin 6 të Rregullores (KE) nr.1592/2002, paragrafi i parë zëvendësohet si më poshtë:

“1. Produktet, pjesët dhe pajisjet do të përputhen me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit që përmbahen në Shtojcën 16 të Konventës së Çikagos, lëshuar në mars 2002, për vëllimin I dhe në nëntor 1999, për vëllimin II, përveç shtesave të Shtojcës 16”.

#### Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi më 28 shtator 2003.

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 24 shtator 2003.

Për Komisionin

**Loyola De Palacio**

Zv/Presidente

[1] GZ L 240, 240, 07.09.2002, fq. 1.